

Tregtia e jashtme e mallrave

Dhjetor 2017


Tiranë, më 17 Janar 2018: Gjatë vitit 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 273 mld lekë, duke u rritur me 12,1 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 626 mld lekë, duke u rritur me 8,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 353 mld lekë, duke u rritur me 5,2 %, krahasuar me 2016.

Eksportet, gjatë këtij viti janë rritur me 12,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +4,9 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +4,4 pikë përqindje, "Ushqim, pije, duhan" me +1,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -1,4 pikë përqindje.

Gjatë këtij viti, importet janë rritur me 8,1 % krahasuar me 2016. Të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, ku grupet që kanë ndikuar më tepër në rritjen vjetore të importeve, janë: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +2,8 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +1,2 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me +1,2 pikë përqindje.

Shkëmbimet tregtare, për vitin 2017, me vendet e BE zënë 66,3 % të gjithë tregtisë. Gjatë këtij viti, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,2 %), Greqia (6,8 %), Gjermania (6,8 %) dhe Kina (6,4 %).

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Për publikim 17/01/2018

Në Dhjetor 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 22 mld lekë, duke u rritur me 0,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 13,5 %, në krahasim me Nëntor 2017. Importet e mallrave në Dhjetor 2017 arritën vlerën 61 mld lekë, duke u rritur me 8,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 11,1 %, në krahasim me Nëntor 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 39 mld lekë, duke u rritur me 14,2 %, krahasuar me Dhjetor 2016 dhe me 32,5 %, në krahasim me Nëntor 2017.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 0,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +4,6 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,8 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -10,5 pikë përqindje.


Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Dhjetor 2017



Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 8,9 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +7,6 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,2 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Dhjetor 2017



Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Dhjetor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Dhjetor 2016 janë: Italia me (17,0 %), Gjermania me (16,8 %) dhe Maqedonia me (19,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova me (-14,7 %), Spanja me (-3,6 %) dhe Greqia me (-17,0 %).

Gjatë këtij viti, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (9,9 %), Kosova me (26,0 %) dhe Spanja me (87,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia me (-24,0 %), Zvicër me (-48,0 %) dhe Holanda me (-4,0 %).

Në muajin Dhjetor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Dhjetor 2016 janë: Italia me (1,4 %), Greqia me (9,5 %) dhe Turqia me (4,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-1,2 %), Gjermania me (-27,3 %) dhe Shtetet e Bashkuara me (-7,8%).

Gjatë këtij viti, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (5,7 %), Turqia me (11,2 %) dhe Greqia me (9,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-7,7 %), Kina me (-2,6 %) dhe Franca me (-4,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Dhjetor 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,3 %, të gjithë tregtisë. Në Dhjetor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,6 %), Kina (6,8 %), Greqia (6,5 %) dhe Gjermania (6,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-21	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	06 - 15	24	7,4	49	-0,8	-25	49,3
	07 - 15	23	-1,6	52	11,1	-29	43,0
	08 - 15	15	-17,3	40	-10,0	-25	38,3
	09 - 15	20	-4,3	44	-7,1	-24	46,3
	10 - 15	20	-9,3	50	-4,2	-30	40,2
	11 - 15	19	-8,9	49	2,0	-30	39,7
	12 - 15	18	-7,6	53	-1,7	-35	33,5
	Janar – Dhjetor 2015	243	2,8	545	9,3	-301	44,7
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-19	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-27	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-31	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-27	42,8
	10 - 16	22	7,3	50	-0,8	-28	43,5
	11 - 16	23	17,5	50	1,0	-27	46,2
	12 - 16	22	22,6	56	4,9	-34	39,1
	Janar – Dhjetor 2016	243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,5	58	15,5	-33	43,1
	11 - 17	25	11,1	55	10,4	-29	46,5
	12 - 17	22	0,6	61	8,9	-39	36,2
	Janar – Dhjetor 2017	273	12,1	626	8,1	-353	43,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	16-Dhj	17-Dhj	Jan.- Dhj . 2016	Jan.- Dhj.2017	16-Dhj	17-Dhj	Jan.- Dhj . 2016	Jan.- Dhj.2017
Vendet e BE-së	15.421	17.206	189.704	210.554	35.903	37.621	365.926	385.656
Austri	85	312	1.188	1.836	341	1.636	6.376	7.708
Mbretëri e Bashkuar	51	93	533	480	384	557	4.159	5.538
Gjermani	718	838	8.282	10.854	6.008	4.371	54.959	50.711
Greqi	1.060	880	11.150	11.602	4.129	4.521	45.656	49.879
Itali	10.010	11.715	132.890	146.036	16.646	16.873	169.583	179.227
Spanjë	1.424	1.373	7.994	14.986	941	1.110	12.676	13.466
Kroaci	60	53	943	839	461	358	4.402	4.434
Të tjera të BE-së	2.012	1.943	26.725	23.919	6.992	8.196	68.115	74.693
Kinë	1.276	371	7.452	8.399	5.324	5.260	50.814	49.484
Kosovë	1.736	1.481	16.605	20.923	585	747	5.819	8.443
Maqedonia	543	648	6.421	8.431	811	763	7.765	8.755
Rusi	0	-	61	89	591	888	10.891	11.779
SHBA	127	524	1.604	3.444	1.165	1.073	10.861	8.888
Turqi	622	140	2.803	2.132	4.092	4.284	45.655	50.775
Ukrainë	-	3	203	455	382	283	3.589	3.201
Zvicër	213	291	2.574	1.339	397	1.672	6.821	13.068
Të tjera	1.898	1.305	16.071	17.199	6.533	8.132	71.107	86.038
Gjithsej	21.836	21.971	243.498	272.965	55.783	60.722	579.248	626.087

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Dhj-16	Dhj -17	Jan.- Dhj . 2016	Jan.- Dhj.2017	Dhj-16	Dhj -17	Jan.- Dhj . 2016	Jan.- Dhj.2017
Gjithsej	21.836	21.971	243.498	272.965	55.783	60.722	579.248	626.087
Ushqime, pije, duhan	2.145	2.561	25.347	30.079	9.222	9.714	100.365	106.732
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.451	3.165	46.564	43.088	4.312	8.565	49.842	65.961
Produkte kimike dhe plastike	308	323	4.358	4.730	7.506	7.754	80.008	86.884
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	144	267	2.596	2.966	1.532	1.669	17.378	18.982
Prodhime druri dhe letre	708	838	7.764	8.309	1.991	1.923	23.357	23.689
Tekstile dhe këpucë	8.306	9.309	106.608	117.375	7.519	7.717	79.971	87.119
Materiale ndërtimi dhe metale	3.299	3.691	31.891	43.802	7.357	5.597	76.002	76.619
Makineri, pajisje dhe pjesë	864	1.188	11.272	15.074	14.181	14.313	130.954	133.989
Të tjera	612	629	7.098	7.542	2.163	3.469	21.372	26.111

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	132.890	146.036	16.605	20.923	7.994	14.986	11.150	11.602
Ushqim, pije duhan	7.925	8.407	2.569	2.856	875	851	2.288	2.003
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	8.647	8.111	3.561	4.874	3.729	11.134	428	323
Produkte kimike dhe plastike	1.270	1.367	1.274	1.180	1	14	437	569
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.321	2.227	0	8	8	91	67	54
Prodhime druri dhe letre	5.730	5.798	327	436	5	9	949	1.083
Tekstile dhe këpucë	84.223	91.490	95	126	2.803	2.594	4.650	5.291
Materiale ndërtimi dhe metale	12.528	16.131	6.828	9.543	535	283	1.799	1.498
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	7.307	9.028	709	715	24	2	141	393
Të tjera	2.939	3.478	1.241	1.185	14	9	391	390

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Turqi		Gjermani		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	169.583	179.227	45.655	50.775	54.959	50.711	45.656	49.879
Ushqim, pije duhan	17.299	18.209	5.224	5.563	4.473	4.446	13.995	13.846
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	18.999	17.072	1.055	1.597	538	926	6.504	7.454
Produkte kimike dhe plastike	16.908	18.832	6.440	7.211	6.719	7.677	7.619	7.995
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	13.608	14.743	360	342	5	52	136	75
Prodhime druri dhe letre	6.574	6.665	3.222	3.373	860	887	2.828	3.306
Tekstile dhe këpucë	40.229	43.368	14.948	16.251	2.560	2.779	3.618	3.892
Materiale ndërtimi dhe metale	16.729	19.976	6.071	6.242	14.743	5.893	6.850	9.189
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	33.595	34.300	6.409	7.881	23.410	25.955	2.620	2.354
Të tjera	5.643	6.062	1.926	2.315	1.651	2.095	1.487	1.769

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Revizionime mujore

Të dhënat që bëhen të disponueshme për muajin e fundit kanë efekt edhe në revizionimin e muajve paraardhës, sepse me ardhjen e të dhënave për muajin e fundit vijnë edhe të dhënat e përditësuara për muajt e mëparshëm si rezultat i përditësimeve të burimit administrativ.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri